

MONITORIMI I PROCESEVE PENALE

MANUAL PËR GAZETARËT

MONITORIMI I PROCESIVE PENALE
MANUAL PËR GAZETARËT

MONITORIMI I PROCESIVE PENALE

MANUAL PËR GAZETARËT



Botuesi

Balkans Policy Research Group
Rr. Qamil Hoxha, No. 29, Prishtina 10000
<http://balkansgroup.org>

Përgatitur nga:

Milan Filipovic, Komiteti i Juristëve për të Drejtat e Njeriut (YUCOM)

Bashkëpunëtorët:

Viktor Gumi, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, Shqipëri
Valza Sadriu, Grupi për Hulumtim të Politikave të Ballkanit, Kosovë
Gordana Lonić, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Bosnie dhe Hercegovinë
Hajdi Sterjova-Simonovik, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Maqedoni

Ky udhëzues është hartuar në kuadër të projektit “Përmirësimi i raportimit për standardet e shtetit ligjor në Serbi, Maqedoni, Shqipëri, Kosovë dhe Bosnje dhe Hercegovinë”¹ me mbështetjen e Shoqatës së Avokatëve Amerikanë, Iniciativa për Shtetin Ligjor (ABA ROLI)

Deklaratat dhe analizat e shprehura janë vetëm ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrimin zyrtar të YUCOM, as nuk janë miratuar nga Dhoma e Delegatëve ose Bordi i Guvernatorëve të Shoqatës së Avokatëve Amerikanë dhe nuk përfaqësojnë pozicionin apo politikën e Shoqatës së Avokatëve Amerikanë. Për më tepër, asgjë në këtë botim nuk duhet të konsiderohet të japë këshilla ligjore për raste specifike.

1 Projekti u zbatua në rajonin e Ballkanit Perëndimor në bashkëpunim me pesë organizata partnere: Komiteti i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut (YUCOM) – Serbia, Tirana Legal Aid Society (TLAS) – Shqipëria, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut RS – Bosnja dhe Hercegovina, Grupi i Kërkimit të Politikave të Ballkanit (BPRG) – Kosovë, dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë – Maqedoni

PËRMBAJTJE

| | | |
|-------------|---|-----------|
| I | HYRJE | 5 |
| II | ÇËSHTJE SPECIFIKE | 7 |
| 1. | SERBIA | 7 |
| 2. | MAQEDONIA | 8 |
| 3. | SHQIPËRIA | 9 |
| 4. | KOSOVA | 10 |
| 5. | BOSNIA DHE HERCEGOVINA | 12 |
| III. | UDHËZIME PËR RAPORTIM | 15 |
| 1. | QASJA NË GJYKATA | 15 |
| 2. | PËRGJEGJËSIA LIGJORE E GAZETARËVE | 17 |
| 3. | TË DREJTAT E TË MITURVE | 19 |
| 4. | PËRMBLEDHJE E KODIT TË PROCEDURES PENALE TË KOSOVËS | 20 |
| IV. | PRAKTIKA E GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT | 25 |



I HYRJE

Ky udhëzues është hartuar në kuadër të projektit “Përmirësimi i raportimit për standardet e shtetit ligjor në Serbi, Maqedoni, Shqipëri, Kosovë dhe Bosnje dhe Hercegovinë” në përpjekje për të mbështetur gazetarët në rajon të tejkalojnë vështirësitë që kërcënojnë pavarësinë dhe profesionalizmin e tyre, dhe t’i aftësojë ata të ushtrjnë rolin e tyre mbikëqyrës në vazhdimësinë e reformave të shtetit ligjor. Në mënyrë që institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre reformave të mbahen përgjegjëse, ato duhen që në mënyrë të vazhdueshme të jenë nën syrin vigjilent të medias së lirë dhe të pavarur. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për sistemin e drejtësisë që synon jo vetëm të ketë një rol ndëshkues, por edhe parandalues. Rol i cili veçanërisht varet nga niveli i besimit të publikut në këtë institucione.

Bërja publike e gjyqimeve sjell përfitime të shumëfishta për të akuzuarit, si dhe për pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit. Njohja e mirë e procedurave penale dhe vlerësimi i mprehtë për raportimin profesional dhe etik, ju mundëson gazetarët të i ofrojnë publikut një pasqyrë shumë të nevojshme mbi punën e gjyqësorit. Raportimi objektiv dhe i balancuar sjell gjyqësorin më pranë qytetarëve, demistifikon tërë procesin si dhe kontribuon në sqarimin se vendimet mbi pafajësinë apo dënimet e perceptuara si të lehta nuk janë gjithmonë produkt i korrupsionit në gjyqësor.

Rindërtimi i besimit të publikut ndaj gjyqësorit është parakusht për reforma të suksesshme dhe të qëndrueshme në një shtet ligjor dhe antarësimin e vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian. Rritja e autoritarizmit dhe rënia e lirisë së mediave paraqet një pengesë të madhe për këto shtete. Të përballur me presione ekonomike, kërcënime dhe sulme fizike, shumë gazetarë përdorin vetëcensurimin, ndërsa të tjerët, me qëllim të përhapjes më të madhe të medias së tyre, përdorin shkrime të stilit “*tabloid*”, duke sjellë kështu rënie të përgjithshme në cilësinë e medias dhe objektivitetin e saj.



II ÇËSHTJE SPECIFIKE

1. SERBIA

Cënimi i prezumimit të pafajësisë përbënë shkeljen kryesore të ligjit si dhe ndër shkeljen më të shpeshtë të kryer nga media². Kjo shkelje dëmton seriozisht besimin e publikut tek gjyqësori, duke i bërë qytetarët të besojnë se vendimet mbi pafajësinë apo dënimet e perceptuara si të lehta janë pasojë e korrupsionit të përhapur në gjyqësor. Ky perceptim vije si pasojë e fakti se kjo shkelje, shpesh, kryhet nga anëtarë të ekzekutivit gjatë apo madje duke i paraprirë arrestimeve në rastet e korrupsionit të bëra publike. Shpesh në këto raste, personat e arrestuar shpallen të pafajshëm duke lënë hapësirë për hamendësime se prokuroria e ka trajtuar rastin e papërgatitur, pa prova të mjaftueshme dhe nën presionin politik të ekzekutivit.

Në disa raste, ndalimi i të akuzuarit është bërë mbi bazën e “shqetësimit publik” duke rrezikuar zhvillimin e qetë dhe të drejtë të procedurave penale. Paradoksalisht, ky “shqetësim publik” shpesh është shkaktuar nga raportimi i mediave tabloide që shkelin prezumimin e pafajësisë. Përderisa sistemi gjyqësor dëmtohet nga përgjegjësia për pagimin e e dëmeve nga ndalimi i jashtëligjshëm, ata të cilët shkelin prezumimin e pafajësisë nuk përballen me pasoja të vërteta. Në kundërshtim me raportet e qeverisë që pretendojnë përfundimin e plotë të masave të Planit të Veprimit të Kapitullit të 23-të i cili ka përqëllim reduktimin e këtij fenomeni të përhapur, autoriteti kompetent për shtypin e shkruar, Ministria e Kulturës dhe Informacionit, nuk ka filluar asnjë procedurë të vetme kundërvajtje gjatë këtyre tre viteve të fundit.³ Duke qenë se procedurat ekzistuese ligjore rrallë përdoren nga autoritetet kompetente, ka nisma të atilla të cilat propozojnë përfshirjen e shkeljes së prezumimit të pafajësisë si vepër penale, e dënueshme me afat burgimi.

Megjithatë, shpesh ky nuk është mjet për presion politik, por mjet për rritjen e shitjeve të medias. Të pandehurit, të drejtat e të cilëve janë shkelur, shpesh janë të mitur ose persona të varfër të cilët janë të dyshuar për kryerjen e një krimi dhe të cilët nuk posedojnë mjetet për financimin e përfaqësimin ligjor në Gjykatën e Lartë në Beograd, e cila është ekskluzivisht kompetente për gjykimin

2 Vëzhgimi i kufizuar i kryer rregullisht nga Këshilli i Shtypit të Shkruar, një organ vetë-rregullues i Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Serbisë (IJAS), vë në dukje afërsisht një mijë shkelje në vit.

3 Këshilli për Zbatimin e Planit të Veprimit për Kapitullin 23, Raporti nr. 2/2018 për Zbatimin e Planit të Veprimit për Kapitullin 23, Beograd, Korrik 2018, Aktiviteti 1.1.6.7, f. 54.

e rasteve ndaj medias. Vlen gjithashtu të theksohet se ligji aktual për ndihmën juridike falas ndalon shprehimisht, ofruesit e ndihmës juridike falas të ofrojnë ndihmë juridike falas në rastet e padive për shpifje, duke kufizuar kështu qasjen në drejtësi për viktimat e shkeljes së prezumimit të pafajësisë që nuk janë në gjendje të paguajnë për përfaqësim ligjor.

2. MAQEDONIA

Lajmet e bujshme në dekadën e fundit kanë qenë atribut kryesor i gazetarisë dhe mediave në Maqedoni. Kjo qasje e komunikimit të lajmeve çoi në një shkelje serioze të të drejtave të të pandehurve dhe/ose viktimave, por gjithashtu edhe në mosrespektimin serioz të standardeve dhe parimeve të shtetit ligjor.

E drejta mbi privatësinë e të pandehurve/viktimave dhe prezumimi i pafajësisë së të pandehurve dhe të dyshuarve në proces janë ato që shkelen dhe cenohen më së shpeshti.

Krijimi i lajmeve sensacionale ishte një mjet propagandues i përdorur nga qeveria e mëparshme për të treguar se ajo po udhëhiqte një luftë serioze kundër korrupsionit dhe krimit, edhe pse më vonë nga procedurat e filluara dhe të përfunduara kundër disa anëtarëve të partisë së mëparshme e cila ishte në pushtet, ishte e qartë se ato veprime të mbuluara me bujë ishin persekutim politik i kundërshtarëve apo fshehje e veprave të tyre penale.

Gjatë kësaj periudhe, pavarësia dhe objektiviteti i mediave në Maqedoni u rrezikua seriozisht. Pjesërisht, procedimet penale të cilat u inicuan kundër anëtarëve të qeverisë së mëparshme si dhe të të ashtuquajturave “bomba” çuan në përfundimin se propaganda dhe buja e madhe e lajmeve u krijuar nga disa media të cilat ishin të paguara mirë nga fondet qeveritare dhe partitë politike. Kjo pozitë e pafavorshme e medias u pasqyrua pothuajse në çdo raport vjetor të Komisionit Evropian, si dhe të organizatave të pavarura ndërkombëtare që monitorojnë nivelin e transparencës, pavarësisë dhe objektivitetin e medias.

Po ashtu në periudhën kur qeveria e mëparshme ishte në pushtet, ka pasur shumë shembuj të persekutimit të numrit të vogël të mediave të pavarura dhe gazetarëve, nga shumica qeverisëse, një lloj disiplinimi i gazetarëve dhe medias me padi për fyerje dhe shpifje. Këto padi të miratuara nga gjykata, imponuan shuma të mëdha dëmshpërblimi për shkelje të reputacionit dhe nderit politikanëve – paditës.

Madje, ka patur edhe raste të ndjekjes penale të gazetarëve të cilët nuk ishin të një mendimi me qeverinë e kaluar dhe që po përpiqeshin të bënin gazetari hulumtuese për të zbuluar aktivitetet e paligjshme të partisë në pushtet, në atë kohë. Një shembull i kësaj është dënimi me burg i gazetarit Tomislav Kezarovski për dyshimin se kishte zbuluar në publik identitetin e një dëshmitari të mbrojtur

në procesin penal, ndonëse sipas tij, arsyeja e vërtetë mbrapa këtij dënimi ishte hulumtimet e bëra nga ky gazetar.

Dështimi për të hetuar vdekjen e gazetarit dhe redaktorit të gazetës javore Focus lë një hapësirë për dyshim legjitim mbi përfshirjen e politikanëve të cilët ishin pjesë e pushtetit në kohë e vdekjes së këtij gazetarit të shquar.

Ky qëndrim i mediave dhe gazetarëve ndikoi seriozisht në krijimin e opinionit publik dhe në kuptimin e procedurave dhe proceseve gjyqësore, pasojat e të cilave ndjehen ende, edhe pas disa viteve të rënies së regjimit. Edhe pse, pas përmbysjes së regjimit të qeverisë së mëparshme media ka shënuar progres në dy vitet e fundit, pavarësia e medias është ende e brishtë dhe objektiviteti i raportimit pengohet nga sensacionalizmi dhe raportimi jo i saktë.

Nga ana tjetër, sipas deklaratave të gazetarëve, mbyllja e institucioneve dhe organeve gjyqësore si dhe mungesa e informacionit të duhur në media, lë hapësirë për krijimin e historive hamendësuese, të cilat po ashtu nuk mbështesin raportimin e duhur dhe efektiv sipas standardeve të shtetit ligjor.

3. SHQIPËRIA

Liria e shtypit dhe prezumimi i pafajësisë janë të domosdoshme për demokracinë, pasi e para mban një publik të informuar dhe e dyta mbron të drejtat e të akuzuarit. Në Shqipëri mediat dhe komunikimi në të gjitha fushat i janë nënshtruar një evolucioni të konsiderueshëm. Si rrjedhojë, marrëdhënia në mes të publikut dhe informacionit ndryshoi.

Zhvillimi i medias në internet dhe rrjetet sociale tani gjeneron një rrjedhë të vazhdueshme informacioni në të cilën publiku dhe media duhet të orientohen. Individët nuk kërkojnë informacion vetë; ata presin që informacioni t'ju vijë. Pra, nocioni i "publikut" ka evoluar: sigurimi i qasjes të publikut në gjykatë nuk perceptohet më si i mjaftueshëm për të marrë një vendim "publik". Qënia e ekzistencës publike nënkupton aksesueshmërinë, e cila nga ana e saj kërkon sjelljen e informacioneve të thjeshta, të kuptueshme dhe të sakta për një gamë sa më të gjerë të individëve.

Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të garantojnë kryerjen e proceseve në pajtim me parimin e shtetit ligjor, prezumimin e pafajësisë, gjykimin e drejtë dhe parimin se drejtësia vihet vetëm nga gjykata.

Atëherë, si funksionon drejtësia nën një presion kaq të lartë të interesave publike dhe medias? Në Shqipëri, prokurori drejton hetimin paraprak dhe ai është përgjegjës për zbulimin e informacionit të marrë gjatë fazës hetimore, përpara gjykimin, prandaj është detyrë e prokurorit të shpjegojë rastin për publikun dhe të garantojë parimet e ndjekjes penale të drejtë dhe prezumimin e pafajësisë.

Informacioni i ofruar për publikun është zakonisht i përgjithshëm pa zbuluar provat dhe duke mbrojtur të gjitha palët në proces, duke përfshirë dëshmitarët, për të mos përmendur viktimat dhe të dyshuarit, në rast të një interesi të lartë publik që matet përmes parimit të proporcionalitetit sipas çështjeve konkrete.

Përmes monitorimit, informacionit dhe mbulimit masiv, media i jep publikut një imazh të realitetit ku jeton dhe përtej, bëhet një aleat i sistemit të drejtësisë nëpërmjet denoncimeve të shkeljeve të zyrtarëve, abuzimeve të tyre dhe abuzimeve të institucioneve të ndryshme dhe kjo është pjesa më e mirë, por nga ana tjetër, ndonjëherë tejkalimi i kufijve të informacionit ose informacioni i pasaktë çon në pasoja katastrofike për jetën e një individi ose të një shoqërie në tërësi.

Mësimet e nxjerra dhe sfidat e ardhshme në Shqipëri:

- ▶ Organet e sistemit ligjor shqiptar duhet të shpjegojnë parimet, zgjedhjet dhe strategjitë e funksionimit të tij në frymën e “shtetit të hapur”;
- ▶ Është e nevojshme të rritet vetëdija për ndikimin dhe rëndësinë e komunikimit, veçanërisht në rastet e nivelit të lartë;
- ▶ Dialogu ndërmjet mediave dhe sistemit ligjor duhet të jetë i vazhdueshëm, veçanërisht, në kohën kur nuk shfaqen “kriza”, sepse atëherë është më e lehtë të zgjidhet “kriza” kur gjendemi përpara saj.
- ▶ Sistemi gjyqësor duhet të dakordësohet me një strategji të komunikimit të procedimeve penale, do të thotë kur, deri në çfarë mase, nga kush dhe për kë duhet të sigurohet informacioni; është e domosdoshme të i përmbahesh kësaj strategjie dhe të përhapësh mesazhin për sfondin dhe natyrën e saj.
- ▶ Sistemi gjyqësor në Shqipëri duhet të garantojë parimin e shtetit ligjor, ndjekjen e drejtë penale dhe prezumimin e pafajësisë.

4. KOSOVA

Në Kosovë, një nga shqetësimet më të mëdha në lidhje me raportimin e mediave për çështjet e shtetit ligjor janë njohuritë e pamjaftueshme të gazetarëve në fushën penale dhe mungesa e informimit të duhur për pasojat që rezultojnë nga raportimi i pasaktë dhe i gabuar.

Bazuar në analizën e vendimeve të marra nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Komisionit të Pavarur të Mediave, shkeljet në raportimin e mediave për rastet penale vijnë si rezultat i mangësive në kuptimin e qartë të fazave të procedurës penale dhe parimeve të kodit penal.

Shkeljet përfshijnë zbulimin e emrit dhe të dhënave personale të individëve në fazat e hershme të hetimit, si dhe nxjerrjen e përfundimeve nga vetë mediat për individë të caktuar të cilët janë pasuruar në mënyrë të paligjshme ose të

ngjashme, por pa paraqitur prova në mbështetje të këtyre pretendimeve. Kjo vjen si rezultat i ndërgjegjësimit të ulët të gazetarëve mbi parimet themelore penale siç është fakti se një individ në Republikën e Kosovës konsiderohet zyrtarisht nën hetim kur prokuroria ka vendosur të inicojë padinë kundër atij individ dhe kur hetimi penal është ende aktiv si dhe nuk ka përfunduar me një vendim përfundimtar.⁴

Shkeljet në rastet e prezumimit të pafajësisë, emërtimi i gabuar i të dyshuarve dhe të akuzuarve dhe për më tepër, arritja në përfundime se disa persona janë autorët e veprës penale përbëjnë shkelje të rënda të mediave në raportim.⁵

Probleme janë identifikuar edhe në trajtimin e të miturve të akuzuar për vepra penale kur informacioni i publikuar mund të ketë zbuluar identitetin e të miturve të akuzuar për një veprë penale e cila përbën shkelje të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.⁶

Një çështje tjetër e diskutueshme në Kosovë është ndërhyrja në jetën private të individëve për të cilët media raporton. Rasti i fundit dhe më përfaqësues i kësaj çështje është shkelja e privatësisë të individëve të përfshirë në akuzën e mashtrimit me listën e veteranëve të UÇK-së, ku u dyshua se disa persona kishin fituar në mënyrë të paligjshme statusin e veteranëve si përfitues ku u bënë publike të dhënat personale të më shumë se 19.000 të individëve, duke përfshirë dhe numrin personal.⁷

Shkelje të tilla nga media nënkuptojnë mungesën e njohurive nga gazetarët për pasojat që mund të vijnë si rezultat i kësaj forme të veçantë të raportimit. Rrjedhimisht, shkelje të tilla si zbulimi i fshehtësisë së procedurës, i identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur ose anonim apo veprime të ngjashme vazhdojnë të ndodhin, pa u ndëshkuar.

Gjithashtu ka raste kur dëshmitë e dhëna pas dyerëve të mbyllura nga një dëshmitar i mbrojtur janë bërë publike në media. Një hetim u fillua edhe kundër

4 Shih: Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Vendimi 683 – 2018. http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2018/10/vendim_KMSHK_683-2018.pdf

5 Shih: Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Vendimi 647-2016. http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2018/07/vendim_KMSHK_647-2018.pdf

6 Shih: Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Vendimi 575-2017. http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/vendim_KMSHK_575-2017.pdf

7 Shih: Kallxo.com. Prokuroria nis hetimet për publikimin e listave të veteranëve. 28 shtator 2018. <https://kallxo.com/prokuroria-nis-hetimet-per-publikimin-e-listave-te-veteraneve/>

një avokati i dyshuar për zbulimin e emrit të dëshmitarit të mbrojtur, në media.⁸ Në këtë rast, ndërsa media raportoi për hetimin e filluar ndaj avokatit, vetë media publikoi, përsëri, emrin e dëshmitarit të mbrojtur për të cilin vetë avokati ishte nën hetim.

Përveç rrezikut të përballjes me pasojat penale, jo pak gazetarë kanë njohuri të mira të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, i cili rregullon mediat e shkruara dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, i cili rregullon sferën e ofruesve të shërbimeve audio-vizuale dhe radio.

5. BOSNIA DHE HERCEGOVINA

Problemi kryesor që paraqitet në raportimin mbi procesin dhe procedurat gjyqësore të cilat janë pjesë e ndjekjes penale apo edhe në procesin e hetimit janë paragjykimet dhe subjektivizmi i gazetarëve dhe i medias në përgjithësi gjatë raportimit mbi këtë temë. Gjithashtu, një pengesë e madhe në raportimin e besueshëm është mungesa e njohurive mbi terminologjinë ligjore; prandaj gazetarët nuk janë në gjendje ta përshtatin çështjen për lexuesit dhe publikun e gjerë. Problemi kryesor në raportim është mungesa e kualifikimi të duhur për procesin si dhe mungesa e njohurive për çështje ligjore.

Mungesa e njohurive në media e cila është e prezente gjatë raportimit kërcënon të shkelë standardet profesionale dhe kodin e etikës së profesionit, si dhe të çojë në shkeljen e prezumimit të pafajësisë dhe zbulimin e identitetit të të miturve. Ndër të tjera, gazetarët nuk kanë njohuri për të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Është obligim themelor i gazetarisë të bëhet përpjekje për raportim të drejtë dhe në kohë duke u bazuar në standarde profesionale dhe etike të raportimit.

Raportim nga gjykimi: “Skandali dhe retorika kombëtare janë përdorur nga mediat deri në atë masë sa e drejta e publikut për informacion të vërtetë bazuar në informacion të saktë dhe të plotë është kompromentuar.”

Gazetarët të cilët raportojnë nga gjykatat duhet të udhëhiqen nga standardet më të larta etike profesionale dhe të njohin rregullat dhe legjislacionin e gjykatës. Të gjitha rastet gjyqësore kryesisht zhvillohen nën sisteme të mbyllura dhe nuk është e lehtë të mirren informacione brenda një afati të caktuar; terminologjia dhe procedurat ligjore janë të ndërlikuara dhe kërkojnë sqarime. Puna e gazetarëve të cilët raportojnë nga gjykatat për krimet e luftës në Bosnie dhe Hercegovinë është akoma më e vështirë për shkak të dëshmimeve shqetësuese të ngjarjeve që gazetarët vetë përjetuan gjatë luftës.

8 Shih: <http://www.treci.os.sud.rs/images/Razno/OstInterniAkti/Uputstvo%20o%20akreditaciji%20novinara.pdf>

Mirela Huković-Hodzic: “Jemi vetëm gazetarë, jo ekspertë ligjorë”. Gjuha e gazetarëve të gjykatave duhet të jetë e kuptueshme për publikun, duhet të sqarojë pse një vendim apo procedurë gjyqësore është pikërisht ajo që është “pa emocione dhe paragjykime”.

Ndodhemi në një situatë ku shpesh harrohet se gazetarët, gjatë raportimit, duhet t’i trajtojnë të dyshuarit dhe të akuzuarit si të pafajshëm derisa gjykata t’i shpallë fajtorë. Në mënyrë që gazetarët të shmangin këtë gabim thelbësor, është e rëndësishme të përdoret një terminologji e qartë dhe e saktë që përcakton statusin e një personi në një procedurë penale. Prezumimi i pafajësisë është një pjesë integrale e së drejtës për një gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, opinionet dhe informacionet lidhur me proceset penale duhet të transmetohen vetëm atëherë kur nuk krijojnë paragjykime mbi prezumimin e pafajësisë së të dyshuarit ose të akuzuarit.

Një problem tjetër në procesin e raportimit është ndikimi politik tek mediat dhe gazetarët, gjë që sjell një raportim të njëanshëm dhe sensacional. Objektiviteti i raportimit ndikohet nga faktori i pronësisë së shtëpive të medias, gazetave, dhe kush i financon ato.

Në Bosnie dhe Hercegovinë ekzistojnë katër sisteme ligjore të cilat operojnë në mënyrë paralele, e cila i shtynë qytetarët drejtë pasigurisë ligjore. Kjo pasiguri rritet ende më shumë kur bëhet fjalë për personat e dënuar për krime lufte. Për të njëjta vepra penale apo për vepra penale të ngjajshme, diferenca në shqiptim të dënimit shkon deri në 20 vjet, varësisht se në cilën gjykatë është zhvilluar procedura.



III. UDHËZIME PËR RAPORTIM

1. QASJA NË GJYKATA

Sistemi i gjykatave në Kosovë përbëhet nga tre nivele të gjykatave: Gjykatat themelore që përbëjnë gjykata të shkallës së parë; Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë dhe Gjykata Supreme, e cila përbënë gjykatën e shkallës më të lartë.

Ligji nr. 06/L-054 për Gjykata përmban dispozita të përgjithshme ligjore të cilat përcaktojnë qasjen në gjykata dhe transparencë gjyqësore.⁹ Neni 7 i këtij ligji thekson se “gjykatat trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë” dhe se çdo person ka të drejtë në “qasje të barabartë në gjykatat dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj”.

Sipas Ligjit për Gjykatat, “të gjitha seancat gjyqësore duhet të jenë të hapura për publikun përpos nëse ligji e përcakton ndryshe”.¹⁰ Ndërsa neni 6 i këtij ligji përcakton se “gjykatat duhet të publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre të zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimet”.

Sipas nenit 292 të Kodit të Procedurës Penale, pas dëgjimit të palëve, gjyqtari apo trupi gjykues, mund të mbyll seancën për publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor apo nga një pjesë të tij nëse është e nevojshme.¹¹ Zakonisht, kjo ndodh për shkak të ruajtjes së sigurisë kombëtare dhe fshehtësisë zyrtare që mbrohet me ligj, mbrojtjes së interesave të fëmijëve, ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit, mbrojtjen e të dëmtuarve apo dëshmitarëve, ruajtjen e konfidencialitetin të informacionit që do të rrezikohej nga publiku, mbrojtjen e jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose pjesëmarrësve tjerë në procedurë.

Kryetari i gjykatës është i ngarkuar me përgjegjësinë për të siguruar se gjykata dhe procedurat para gjykatës janë të hapura dhe transparente për publikun.¹² Ai po ashtu është përgjegjës për të siguruar qasjen e publikut në gjykatat, përfshirë këtu edhe qasjen e personave nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë.

9 Shih: Ligji nr. 06/L-054 për Gjykata. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18302>

10 Ibid., Neni 7.

11 Shih: Projekt Kodi i Procedurës Penale. Neni 292. <http://kryeminis-tri-ks.net/wp-content/uploads/2019/01/PROJEKT-KODI-I-PROCE-DURES-PENALE.pdf>

12 Ibid. Neni 299.

Kodi i Procedurës Penale parasheh rregulla në bazë të cilave gjykatësi mban rendin në gjykatore dhe rregullon prezencën e medias në gjykatore. Sipas nenit 299 të këtij Kodi, gjyqtari apo kryetari i trupi gjykues, pas hapjes së seancës paralajmëron personat e pranishëm në seancën gjyqësore që të sillen si duhet dhe të mos pengojnë punën e gjykatës. Ai po ashtu ka të drejtë të urdhërojë kontrollin personal të personave të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor. Paragrafi i 4-të i këtij neni parasheh që palët dhe mbrojtësit mund të bëjnë incizim audio të shqyrtimit gjyqësor të hapur i cili mund të përdoret vetëm për qëllimet e të drejtave procedurale dhe pjesëmarrjes së tyre në procedurë penale. Ndërkaq që të dhënat personale të palëve të përfshira mbeten në fshehtësi dhe mund të përdoren vetëm gjatë procedurës penale.

Tutje, në paragrafin e 5-të të këtij neni, theksohet se fotografimi, filmimi, regjistrimi televiziv dhe regjistrime të tjera përpos regjistrimit zyrtar të shqyrtimit gjyqësor janë të lejuara, përveç nëse gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues i kufizon regjistrime të tilla me aktvendim të arsyetuar me shkrim. Ndërsa, në rast se lejohet incizimi i shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari ka të drejtë të ndalojë incizimin e pjesëve të posaçme të seancës.

E drejta e qasjes në dokumente publike garantohet me anë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përmes nenit 4, si dhe nëpërmjet neneve të tjera të cilat garantojnë transparencën e institucioneve publike.

Kuvendi i Kosovës po ashtu ka miratuar Ligjin nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, i cili garanton qytetarëve qasjen në dokumente të institucioneve publike.¹³ Bazuar në nenin 5 të këtij ligji, të gjitha institucionet publike janë të obliguara të caktojnë zyrtarin i cili është përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente. Të gjitha kërkesat duhet të i drejtohen njësisë apo zyrtarit për komunikimin të institucionit përkatës.

Çdo institucion publik është i obliguar që brenda shtatë ditësh të marr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar apo të jap shpjegime se pse kërkesa është refuzuar.¹⁴ Në rast se kërkesa refuzohet, kërkuuesi ka të drejtë mbas 15 ditësh prej ditës kur ka marrë përgjigjen nga institucioni publik të parashtojë kërkesën për rishqyrtim të vendimit ndaj kërkesës së parashtruar. Në rast të përgjigjes negative, kërkuuesi ka të drejtë të fillojë procedurën tek organet kompetente siç është Avokati i Popullit apo institucionet e tjera. E drejta për qasje në dokumente publike po ashtu garantohet me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

Deri më tash, të gjitha gjykatat në Kosovë kanë caktuar zyrtar për komunikim me publikun, përpos gjykatës themelore në Mitrovicë. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka zhvilluar po ashtu disa strategji dhe plane strategjike të cilat kanë pasur si qëllim kryesor avancimin e komunikimit të gjykatave në raport me publikun dhe mediat.

13 Shih: Ligjin nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>

14 Ibid., Neni 7.

2. PËRGJEGJËSIA LIGJORE E GAZETARËVE

Në Kosovë ekziston Këshilli i Mediave të Shkruara, i cili është një trup vetërregullues dhe i cili vepron mbi bazën e respektimit të kodit etik të gazetarisë si dhe fjalës së lirë.¹⁵ Këshilli është organizatë jo-qeveritare dhe vepron në mënyrë të pavarur. Pjesë e këtij Këshilli janë një numër i mediave të shkruara përfshirë gazetat e përditshme, portalet e lajmeve, portalet, gazetat periodike, revistat dhe agjencitë e lajmeve.

Ky Këshill ka përpiluar Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës i cili është i obligueshëm për gazetarët, reporterët, redaktorët, pronarët dhe botues të gazetave, portalet dhe agjencitë e lajmeve.¹⁶ Kodi përfshinë dispozita të përgjithshme në bazë të së cilave detyrat e gazetarëve dhe redaktorëve përfshijnë respektimin e të drejtës së qytetarëve për informim me kohë dhe në tërësi, duke mbrojtur parimet e lirisë së informimit, të drejtën e komentimit të duhur dhe të gazetarisë kritike. Tutje, këto dispozita theksojnë se mediat duhet të respektojnë standardet ndërkombëtare të mirësjelljes dhe të diversitetit etnik, kulturor e fetar, duke mos inkurajuar asnjëherë qëllimisht apo tërthorazi diskriminimin apo jo tolerancën.

Sipas këtij kodi, puna e gazetarëve duhet të mbështetet në burime të besueshme të informacionit dhe në këtë mënyrë të respektojnë të vërtetën faktike dhe të drejtën e publikut që të dijë të vërtetën. Media janë të obliguara që të mbrojnë identitetin e atyre të cilët ofrojnë informacion në konfidencë, si dhe që asnjëherë mos të përdorin fotografitë apo dokumentet të cilat do të qonin në keqinformimin e publikut.

Ky kod po ashtu parasheh dispozita të tjera në bazë të cilave mediat dhe gazetarët duhet të i ikin nxitjes së veprimeve të dhunshme dhe gjuhës së urrejtës.¹⁷ Trajtimi me paragjykim ndaj një individ apo grupi mbi bazë të përkatësisë gjinore, etnike, fetare, racore e të tjerë, si dhe përdorimi i shprehjeve denigruese me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individ apo grupi mbi këto baza, nxit urrejtje dhe pabarazi.

Në mënyrë eksplicite, ky kod thekson se në rast të raportimit për personat e akuzuar për vepra penale, mediat dhe gazetarët nuk duhet të trajtojnë asnjë individ si fajtor, para së një gjë e tillë të confirmohet nga gjykata.¹⁸ E njëjta po

15 Shih: Statuti i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Prembula <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Statuti-.pdf>

16 Shih: Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës. Prembula. <http://press-council-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Kodi-i-Mediave-t%C3%AB-Shkruara-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-.pdf>

17 Ibid., Kapitulli i III: Nxitja dhe gjuha e urrejtjes.

18 Ibid., Kapitulli i V: Personat e akuzuar për vepra penale.

ashtu vlen për privatësinë e individëve, përveç në raste kur kërkimet mbi jetën personale të një individi janë në interes të publikut.

Këshilli i Mediave të Shkruara shqyrton ankesat lidhur me shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara, të cilat mund të paraqiten nga kushdo, nëpërmjet faqes së internetit, e-mail apo me anë të paraqitjes fizike të kopjes.¹⁹ Ankesa të cilat i drejtohen Këshillit mund të ngritën vetëm ndaj gazetës në tërësi dhe jo kundër gazetareve në mënyrë individuale.

Afati kohor për të paraqitur një ankesë është brenda një muaji nga data e publikimit të materialit, ndërkaq që vendimi merret më së largu tre muaj pas paraqitjes së ankesës. Gazeta ndaj të cilës është paraqitur ankesa ka mundësi që brenda pesëdhjetë ditësh të përgjigjet dhe komentojë në Këshill.

Kuvendi i Kosovës po ashtu ka miratuar Ligjin civil nr. 02/L-65 kundër shpifjes dhe fyerjes i cili ka për qëllim të rregullojë përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje.²⁰ Sipas këtij ligji, shpifja nënkupton “publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër” ndërsa fyerja nënkupton “deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese”. Përgjegjësinë për shpifje apo fyerje e bartë personi i cili ka kryer apo ka përhapur shpifje apo fyerje ndaj një individi.²¹

Sipas nenit 5 të Ligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes, nëse veprime të këtilla kryhen nëpërmjet medias, atëherë autori, redaktori apo publikuesi konsiderohen përgjegjës individual apo bashkëpërgjegjës. Ligji po ashtu parasheh raste të përgjegjësisë nga përgjegjësia si dhe cakton kufijtë e përgjegjësisë për veprime të tilla. Neni 9 i këtij ligji liston rrethanat të cilat e përjashtojnë individin nga bartja e përgjegjësisë për deklarata të dhëna, disa prej të cilat përfshijnë të tilla si deklaratat e dhëna gjatë punimeve të organeve legjislative, deklaratat gjatë çdo faze të procedurave parajyqësore, gjyqësore ose administrative, nga kushdo që është i përfshirë direkt në këtë procedurë (përveç kur deklarata në fjalë nuk lidhet me procesin gjyqësor), deklarata të bëra para Avokatit të Popullit dhe të tjera.

Sipas ligjit në fjalë, kompensimi për shpifje duhet të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar.²² Kompensimi në raste të tilla caktohet me qëllim të korigjimit të dëmit të shkaktuar ndaj reputacionit të personit në fjalë ose për të kompensuar çfarëdo humbje financiare apo dëm material të shkaktuar. Kompensimi dhe

19 Shih: Statuti i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Neni 3. <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Statuti-.pdf>

20 Shih: Ligji civil nr. 02/L-65 kundër shpifjes dhe fyerjes. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2503>

21 Ibid. Neni 5.

22 Ibid., Neni 14.

lartësia e kompensimit për humbjet financiare apo dëmin material të shkaktuar caktohet nga gjykatat përgjegjëse varësisht nga rrethanat, pesha e dëmit si dhe gjendja materiale e personit që ka shkaktuar dëmin.

3. TË DREJTAT E TË MITURVE

Në Kosovë, të drejtat e të miturve garantojnë nëpërmjet të akteve më të larta ligjore si dhe nëpërmjet të konventave ndërkombëtare të cilat aplikohen direkt në ligjet e Kosovës. Përveç kornizës ligjore, në kodin e lartë përmendur për mediat e shkruara në Kosovë, kapitulli i gjashtë i këtij kodi i dedikohet mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve gjatë raportimit të gazetarëve në media ku përfshihet kjo kategori. Sipas këtij kapitulli, gazetaret apo mediat:

- ▶ Nuk duhet t'i intervistojnë apo fotografojnë fëmijët të cilët janë nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare rreth çështjeve që kanë të bëjnë me familjen e tyre, pa pëlqimin e prindërve apo të ndonjë të rrituri i cili është përgjegjës për fëmijën.
- ▶ Në asnjë mënyrë nuk duhet të identifikohen në media fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare të cilët janë të përfshirë në vepra penale, qoftë si dëshmitarë, apo të pandehur.
- ▶ Trajtimi i rrëfimeve të tragjedi personale duhet të zhvillohet me kujdes, ndërkohë që ndaj individëve të prekur nga tragjedia duhet pasur qasje mirëkuptimi dhe diskrecioni.²³

Si rezultat i këtij kapitulli, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës së bashku me Zyren e UNICEF në Kosovë kanë hartuar një Udhëzues për Mbrojtjen e Fëmijëve në Media, i cili jep shpjegime të detajuara mbi zbatimin e kapitullit të gjashtë të këtij kodi.²⁴

Udhëzuesi për mbrojtjen e fëmijëve në media ofron një numër të rekomandimeve se si një gazetarë apo media duhet të veprojë në rast të intervistimit dhe raportimit të fëmijëve. Sipas këtij udhëzuesi, ndër të tjera, gazetaret duhet të i kushtojnë rëndësi ndjeshmërisë së temës, mirëqenies fizike dhe emocionale të fëmijës, përkatësisë kulturore, etnike, religjioze, si dhe përvojave personale të tij. Po ashtu, gazetari duhet të kujdeset që raportimi në të cilin është përfshirë një fëmijë nuk do ta dëmtojë atë dhe nuk do të e prezantojë në kontekst negative.

23 Shih: Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës. Kapitulli i VI: Mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve. <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Kodi-i-Mediave-t%C3%AB-Shkruara-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-.pdf>

24 Shih: Udhëzues për Mbrojtjen e Fëmijëve në Media. <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-Mbrojtjen-e-F%C3%ABmij%C3%ABve-n%C3%AB-Media.pdf>

Tutje, ky udhëzues ofron një listë të quajtur “Lista kontrolluese” për gazetarë, e cila rekomandohet të përdoret nga gazetarët gjatë përgatitjes së lajmit ky përfshihen të miturit, si dhe pas publikimit të tij.

Në përmbledhjen e vendimeve për vitin 2017, Këshilli i Mediave të Shkruara në Kosovë kishte miratuar një ankesë të paraqitur nga Aurora Susuri Gunga e cila kishte paraqitur ankesën kundër Gazetës Blic dhe portalit të revistës Kosovarja pasi që kishin publikuar një artikull i cili përmbante fotografinë të fëmijëve të saj, të cilat ishin publikuar *“pa lejen, dijeninë dhe miratimin e prindit”*.²⁵ Në vendim, thuhet se Bordi i Këshillit kishte marrë këtë vendim duke u bazuar në kapitullin e gjashtë të kodit për mediat e shkruara i cili i referohet mbrojtjes së fëmijëve dhe kapitullit të shtatë, i cili i referohet privatisë dhe shmangies nga ndërhyrja dhe kërkimet në jetën private të një individi të cilat nuk janë me interes për publikun.

4. PËRMBLEDHJE E KODIT TË PROCEDURES PENALE TË KOSOVËS

Shkrimi i lajmeve të qarta, të plota, të kuptueshme dhe të sakta nuk është i mundur pa u përgjigjur në pesë pyetje gazetareske: kush, çfarë, ku, kur dhe pse. Thelbi i punë gazetareske është përgjigjja në pyetjen pse, e cila nuk mund të ipet pa njohuri adekuate të koncepteve ligjore të përdorura në sallën e gjyqit. Gazetarët duhet të jenë të vetëdijshëm për rolet e pjesëmarrësve në procedurë penale, të drejtat dhe detyrimet e tyre, fazat e procesit dhe shumë çështje të tjera që mund të gjenden në legjislacionin përkatës substancial dhe procedural.

Një ndër sfidat më të mëdha në monitorimin e vazhdueshëm të gjykimeve në procedurat penale është kohëzgjatja e tyre, meqë gjykimet, edhe për raste të drejtpërdrejta, mund të zgjasin me vite. Si rrjedhojë kemi një rënie në besimin e qytetarëve në gjyqësor dhe zhvendosje të vëmendjes nga shumë problemeve me të cilat gjyqësori përballet në punën e tij dhe të cilat kërkojnë reforma serioze.

Vetëm përmes përgatitjes dhe njohurive të mira, është e mundur të komunikohet dhe të përkthehet gjuha formale dhe e dendur e normave ligjore në një gjuhë që është e kuptueshme për publikun e gjërë tek të cilët duhet të arrijë një informacion.

Meqenëse mungesa e njohurive ligjore dhe e terminologjisë juridike përbën një nga çështjet më të sfiduese gjatë raportimit në procedurat penale dhe punën e gjyqësorit në rajonin e Ballkanit Përendimor, ky seksion është zhvilluar me qëllim që t’u ofrojë gazetarëve një pasqyrë mbi zhvillimin e procedurës penale dhe deri në çfarë mase gjykatat mund të jenë të hapura për publikun.

25 Shih: KMSHK. Përmbledhje e vendimeve 2017. <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2018/11/Permbledhje-e-vendimeve-2017.pdf>

Më poshtë është paraqitur një përmbledhje e draftit të ri të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), ku përmbledhen katër fazat kryesore të procedurës penale përfshirë fazën e hetimit, paraqitjen e aktakuzës, shqyrtimin gjyqësor si dhe mjetet juridike.²⁶ Ky Kodi parashihet të hyjë në fuqi në janar të vitit 2020.

4.1 HETIMI

Procedura penale në Kosovë kryhet nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e prokurorit të shtetit. Meqë hetimi kryhet nga prokurori i shtetit, kontrolli mbi veprimet dhe ligjshmëria e tyre plotësohet nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Faza e hetimit fillon me paraqitjen e një kallëzimi penal, i cili duhet t'i dorëzohet prokurorit të shtetit me shkrim, me anë të komunikimit teknik ose me gojë. Kallëzimi penal mund të dorëzohet nga Policia sipas nenit 81 të KPPK-së ose nga çdo individ ose i dëmtuar. Bazuar në të dhënat dhe provat e mbledhura, policia harton një raport penal në të cilin paraqiten provat e zbuluara në procesin e mbledhjes së të dhënave.²⁷

Bazuar në nenin 102 të KPPK-së, hetimi fillon me vendimin e prokurorit të shtetit, një kopje e të cilit duhet t'i dërgohet gjyqtarit të procedurës paraprake. Ky vendim specifikon:

- ▶ Nëse dihet, personi ose personat kundër të cilëve do të kryhet hetimi;
- ▶ Data dhe koha e fillimit të hetimit
- ▶ Një përshkrim të aktit i cili specifikon elementet e veprës penale
- ▶ Emri ligjor i veprës penale
- ▶ Rrethanat dhe faktet që vërtetojnë dyshimin e arsyeshëm për një vepër penale, nëse janë autorizuar masa teknike apo të fshehta të hetimit ose mbikëqyrjes, si dhe
- ▶ Dëshmi dhe informacione që janë tashmë mbledhur.

Pasi të fillohet hetimi, fillon faza e mbledhjes së informacionit mbi çështjen penale. Kodi i Procedurës Penale i Kosovës siguron rregulla në bazë të të cilave mbledhja e informacionit është kryer në fazën e hetimit. Neni 156 i këtij Kodi përcakton rastet kur prokurori i shtetit mund ta ndërpresë hetimin.

Megjithatë, nëse një hetim është iniciuar, afati brenda të cilit duhet të përfundojë është dy vite. Nëse aktakuza nuk është ngritur brenda kësaj periudhe apo nuk është pezulluar, hetimi duhet të përfundojë automatikisht.²⁸

26 Shih: Projekt Kodi i Procedurës Penale. <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/01/PROJEKT-KODI-I-PROCEDURES-PENALE.pdf>

27 Ibid., Neni 79.

28 Ibid., Neni 157.

4.2 AKTAKUZA

Kosova ka një sistem ligjor ku ndjekja penale kryhet vetëm përmes aktakuzës së prokurorit, e cila paraqitet në gjykatën kompetente²⁹ pas një hetimi të përfunduar dhe në bazë të informacioneve të siguruara, të cilat janë të mjaftueshme për të dyshuar se i pandehuri ka kryer një veprë penale.³⁰

Informacionet që duhet të përfshihen në përmbajtjen e aktakuzës janë specifikuar në nenin 238 të KPPK-së. Sipas këtij neni, aktakuza ndër të tjera duhet të përmbajë:

- ▶ Një tregues të gjykatës se ku do të mbahet gjykimi;
- ▶ Emri i plotë i të pandehurit dhe të dhënat e tij personale;
- ▶ Nëse do të zbatohet paraburgimi ose masat e tjera dhe për sa kohë;
- ▶ Emrin ligjor i veprës penale së bashku me citimin e dispozitave të kodit penal;
- ▶ Koha dhe vendi i veprës penale, si dhe objekti ose instrumenti me të cilin është kryer vepra penale.
- ▶ Shpjegim për arsyet në bazë të të cilave është ngritur aktakuza.

Qasja në aktakuzë nuk lejohet deri në mbajtjen e seancës fillestare. Pas dëgjimit fillestar, vetëm disa pjesë të aktakuzës, siç është emri i të pandehurit, viti i lindjes, kualifikimi ligjor dhe përmbledhja e veprës mund të bëhen publike.³¹ Ndërsa pjesët e tjera, të tilla si përmbledhja narrative e provave, lista e ekspozitave, dëshmitarët e thirrur në gjykimet kryesore, ose ndonjë diskutim mbi aktakuzën në lidhje me sfondin e tij, arsyetimin ose provën mbështetëse, nuk janë të qasshme për publikun derisa Gjykata Themelore nuk ka dhënë një vendim. Muaji dhe dita e lindjes, adresa e të pandehurit ose numri personal përbëjnë informacionet që nuk duhet të bëhen asnjëherë publike.

4.3 GJYKIMI

Seanca fillestare fillon para gjykatësit të vetëm në gjykatën ku është ngritur aktakuza. Në këtë seancë, gjyqtari i vetëm gjykues mund të vendosë për çdo mocion me qëllim të shtrirjes ose zbatimit të masave që sigurojnë praninë e të pandehurit. Një seancë e dytë po ashtu caktohet. I pranishëm në seancën fillestare duhet të jetë prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi.³²

Ndërsa gjyqtari i vetëm gjykues përcakton ditën, orën dhe vendin e shqyrtimit gjyqësor me anë të një urdhri,³³ personat e thirrur në shqyrtimin gjyqësor përfshijnë të

29 Ibid., Neni 239.

30 Ibid., Neni 237.

31 Ibid., Neni 240.

32 Ibid., Neni 243.

33 Ibid., Neni 284.

akuzuarit, avokatin e tyre mbrojtës, prokurorin e shtetit, palën e dëmtuar, përkthyesin, dëshmitarët si dhe ekspertë të propozuar nga prokurori i shtetit ose i akuzuari.³⁴

Gjykimi kryesor është i hapur për publikun³⁵ përveç nëse gjyqtari vendos ndryshe për shkak të arsyeve të renditura në nenin 292. Përrjashtimi i publikut nga gjyqtari duhet të justifikohet, ndërkohë që aktvendimi për përjashtimin e publikut duhet bërë publik.³⁶ Fotografimi dhe inxhizimi i gjykimit përveç atij zyrtar është i lejuar, përveç nëse gjyqtari vendos të kufizojë këto veprime me vendim me shkrim.³⁷

Pasi gjykata të ketë dhënë aktgjykimin, gjyqtari i vetëm gjykues e shpall aktgjykimin në datën e caktuar nga gjykata. Në pajtim me Ligjin për Gjykata, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga data e lëshimit, të gjitha aktgjykimet duhet të publikohen nga gjykatat.

Në Kosovë, publikimi i aktgjykimeve rregullohet me Udhëzimin Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 02/2016, i cili parasheh që vetëm aktgjykimet përfundimtare dhe anonime mund të publikohen.³⁸

4.4 MJETET JURIDIKE

Lloji dhe rregullat e përgjithshme të mjeteve juridike si paanshmëria, përmbajtja dhe afatet kohore janë shpjeguar në Kapitullin 21 të KPPK-së. Sipas nenit 377 të KPCRK-së, pala mund të kërkojë mjete juridike nga një gjykatë e shkallës më të lartë duke parashtruar ankesë kundër aktgjykimit ose aktvendimit të një gjykate të shkallës më të ulët. Për shembull, nëse aktgjykimi është dhënë nga Gjykata Themelore, ankesa duhet të paraqitet në Gjykatën e Apelit dhe nëse aktgjykimi është dhënë nga ky i fundit, ankesa duhet të paraqitet në Gjykatën Supreme. Kundërshtimi ndaj vendimit të Gjykatës Themelore përbënë po ashtu një lloj të mjetit juridik.

Personat e autorizuar për të paraqitur ankesë përbëhen nga prokurori i shtetit, mbrojtësi, i akuzuari, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari. Ndërsa personi, prona e të cilit është konfiskuar mund po ashtu të paraqesë ankesë. Arsyet pas të cilave personat e autorizuar paraqesin ankesë janë të ndryshme.

34 Ibid., Neni 291.

35 Ibid., Neni 294.

36 Ibid., Neni 294.

37 Ibid., Neni 299.

38 Shih: Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Udhëzimi administrativ nr. 02/2016 për anonimizimin dhe publikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.



IV. PRAKTIKA E GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka rëndësi të veçantë në sistemin ligjor, duke siguruar që gjykatat vendase duhet t'u përmbahen interpretimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut gjatë marrjes së vendimeve të tyre. Puna e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i ka dhënë formë një sërë standardesh ligjore që janë me rëndësi të madhe për lirinë dhe përgjegjësinë e mediave.

Ndërmjet të tjerash, shumica e standardeve theksojnë se zyrtarët publikë duhet të zhvillojnë një shkallë më të lartë të tolerancës ndaj kritikave publike³⁹, se liria e shprehjes nënkupton të drejtën për të shprehur informacione dhe qëndrime që ofendojnë dhe trondisin, dhe të drejtën për një farë teprimi dhe provokimi të caktuar në çështjet e interes publik⁴⁰. Në praktikë, GJEDNJ e vë theksin tek roli i mediave si kujdestar i interesit publik (mbikëqyrës) që gëzon mbrojtje të veçantë⁴¹, duke u shprehur se një mbrojtje e tillë është siguruar për gazetarët të cilët japin informacion të besueshëm dhe të saktë në mirëbesim dhe në përputhje me etikën gazetareske⁴². Megjithatë, ajo, gjithashtu, shprehet se profesionalizmi i gazetarëve nuk duhet të vlerësohet në mënyrë shumë të rreptë, pasi kjo mund të ketë efekt pengues⁴³. Për të nxitur një diskutim publik mbi çështjet e interesit publik, GJEDNJ ka vlerësuar se bashkëbiseduesit duhet t'i lejohej e drejta për të dhënë

39 Shih: Ligens kundër Austrisë, kërkesa nr. 9815/82, 8 July 1986; Lepojić kundër Serbisë, kërkesa nr. 13909/05, 6 Nëntor 2007; Bodrožić kundër Serbisë, kërkesa nr. 32550/05, 23 Qershor 2009; Jerusalem kundër Austrisë, kërkesa nr. 26958/95, 27 Shkurt 2001; Birol kundër Turqisë, kërkesa nr. 44104/98, 1 Qershor 2005;

40 Shih: Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 5493/72, 7 Dhjetor 1976; Ligens kundër Austrisë, kërkesa nr. 9815/82, 8 Korrik 1986; Cumpana dhe Mazare kundër Rumanisë, kërkesa nr. 33348/96, 17 Dhjetor 2004; Lopes Gomes de Silva kundër Portugalisë, kërkesa nr. 37698/97, 28 Dhjetor 2012; Prager dhe Oberschlik kundër Austrisë, kërkesa nr. 11662/85, 23 Maj 1991; Dalban kundër Rumanisë, kërkesa nr. 28114/95, 28 Shtator 1999; Castells kundër Spanjës, kërkesa nr. 1798/85, 23 Prill 1992;

41 Shih: Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 13585/88, 26 Nëntor 1991;

42 Shih: Goodëin kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 17488/90, 27 Mars 1996; Fressoz dhe Roire kundër Francës, kërkesa nr. 29183/95, 21 Janar 1999; Bladet Tromso dhe Stensaas kundër Norvegjisë, kërkesa nr. 21980/93, 20 Maj 1999;

43 Shih: Yordanova dhe Toshev kundër Bullgarisë, kërkesa nr. 5126/05, 2 Tetor 2012.

një përgjigje proporcionale⁴⁴, se një masë e caktuar e diskutimeve politike që dalin në sferën private është normale dhe e lejueshme⁴⁵ dhe se liria e shprehjes gëzon një shkallë më të lartë mbrojtjeje në fushatat zgjedhore⁴⁶. Në praktikë, Gjykata thekson se deklaratat për vlerat duhet të bazohen në fakte të mjaftueshme⁴⁷ dhe se konteksti i raportimeve të medias duhet të merret parasysh kur bëhet fjalë për transmetimin e gjuhës së urrejtjes⁴⁸. Siç thuhet në vendimet e shumta të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duhet të ketë një “nevojë urgjente sociale” për të kufizuar lirinë e shprehjes⁴⁹ dhe kjo domosdoshmëri duhet të provohet bindshëm⁵⁰. Përveç standardeve të mësipërme që janë me rëndësi të madhe për lirinë dhe përgjegjësinë e medias, në vijim është një pasqyrë e shkurtër e praktikës gjyqësore relevante të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

ALLENET DE RIBEMONT kundër FRANCËS⁵¹

Rasti i Allet de Ribemont kundër Francës ka të bëjë me komentet e bëra në një konferencë shtypi mbi temën e buxhetit të policisë franceze. Ministri i Brendshëm, Drejtori i Departamentit të Hetimeve Penale të Parisit dhe Shefi i Skuadrës së Krimit dhanë komentet e tyre lidhur me hetimin që ishte në proces. Në këtë rast, kërkuesi u deklarua si nxitës dhe bashkëpunëtor në vrasjen e një deputeti dhe një ish ministri, i cili u vra përpara shtëpisë së Kërkuesit. Deklarata të tilla krijuan në publik bindjen se kërkuesi ishte fajtor dhe pasoja e mëtejshme ishte presioni në gjykatë, në marrjen e vendimit. Ky rast konfirmoi qëndrimin se detyrimi për të respektuar prezumimin e pafajësisë duhet të zbatohet edhe ndaj zyrtarëve publikë dhe jo vetëm ndaj anëtarëve të gjyqësorit.

-
- 44 Shih: Nilsen dhe Johnsen kundër Norvegjisë, kërkesa nr. 23118/93, 25 Nëntor 1999; Lopes Gomes de Silva kundër Portugalisë, kërkesa nr. 37698/97, 28 Dhjetor 2012; Prager and Oberschlik kundër Austria, kërkesa nr. 11662/85, 23 Maj 1991;
- 45 Shih: Lopes Gomes de Silva kundër Portugalisë, kërkesa nr. 37698/97, 28 Dhjetor 2012;
- 46 Shih: Boëman kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 24839/94, 19 Shkurt 1998;
- 47 Shih: Pedersen and Baadsgaard kundër Danimarkës, kërkesa nr. 37698/97, 19 Qershor 2003;
- 48 Shih: Jersild kundër Danimarkës, kërkesa nr. 15890/89, 23. Shtator 1994;
- 49 Shih: Bodrožić kundër Serbisë, kërkesa nr. 32550/05, 23 Qershor 2009; Lindon, Otchakovsky-Laurens dhe July kundër Francës, kërkesa nr. 21279/01 dhe 364487/02, 22 Tetor 2007;
- 50 Shih: Kobenter und Standards Verlags GMBH kundër Austrisë, kërkesa nr. 60899/00, 2 Shkurt 2007; Nilsen dhe Johnsen kundër Norvegjisë, kërkesa nr. 23118/93, 25 Nëntor 1999;
- 51 Shih: Allet de Ribemont kundër Francës, kërkesa nr. 15175/89., 10 Dhjetor 1995;

PELTEREAU-VILLENEUVE kundër ZVICRES⁵²

Në këtë rast kërkuesi ishte një prift i cili ishte i dyshuar për ngacmim seksual. Për shkak se ngjarjet në fjalë datonin në vitet 1991 dhe 1992, ato kishin kaluar afatin e parashkrimit dhe prokurori publik duhej të ndërpriste procedimin penal. Në vendimin e tij i cili u bë publik, prokurori bëri referenca për faktin se prifti i pranoi këto krime, por për shkak të parashkrimit, procedimi i veprës penale duhej ndërprerë. Kërkuesi paraqiti kërkesë për një vendim të ri, i cili duhet t'i referohej vetëm faktit se ndjekja penale ishte mbyllur për afatin e parashkrimit. Më pas, kisha ndërmori procedime kundër kërkuesit gjatë së cilës u citua disa herë vendimi i prokurorit publik. Kërkuesi u detyrua të japë dorëheqjen nga kleri, por ky vendim u anulua përfundimisht nga kongregacioni i tij. Në vendimin e saj GJEDNJ konstatoi se e drejta e kërkuesit ishte shkelur dhe se nuk kishte asnjë justifikim për prokurorin publik që ta konfirmonte akuzën në vendimin e tij për të ndërprerë procedimin. Gjithashtu, gjykata mori në konsideratë faktin se vendimi u bë publik dhe se reputacioni i kërkuesit ishte cenuar seriozisht.

BÉDAT kundër ZVICRËS⁵³

Në këtë rast, kërkuesi pretendoi se gjoba e vendosur nga Gjykata Federale për publikimin e informacionit të siguruar nga sekreti i hetimit penal kishte shkelur të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. Ai argumentoi se Gjykata nuk mund të vërtetonte se artikulli i kontestuar kishte ndonjë ndikim në gjykim dhe se parimi i prezumimit të pafajësisë nuk mund të pengonte individët që të krijojnë opinion e tyre mbi një çështje para përfundimit të një gjykimi. GJEDNJ vendosi që edhe pse ishte e vërtetë që neni 10 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore mbron të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të drejtën për informimin, gazetarët duhej të respektonin të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, duke përfshirë prezumimin e pafajësisë. Megjithëse artikulli i kundërshtuar nuk mbante qëndrim të veçantë mbi fajësinë e të akuzuarit, natyra e tij sensacionaliste, toni tallës dhe mënyra se si gazetari theksoi mosbesimin ndaj të akuzuarit cënonin prezumimin e pafajësisë.

TOURANCHEAU DHE JULY kundër FRANCËS⁵⁴

Në *Tourancheau dhe July kundër Francës*, GJEDNJ vendosi se ndërhyrja e Qeverisë për të ndaluar përkohësisht publikimin e një artikulli për procedimin penal përsa gjykimi ishte ende në vazhdim, ishte i justifikuar për të mbrojtur të drejtën e prezumimit të pafajësisë së të akuzuarit. Faktet që artikulli ishte qartësisht i njëanshëm, se ekstraktet procedurale të cituara nuk ishin objektive

52 Shih: Peltereau-Villeneuve kundër Zvicrës, kërkesa nr. 60101/09, 21 Janar 2015;

53 Bédat kundër Zvicrës, nr. 56925/08, 29 Mars 2016

54 Tourancheau dhe July kundër Francës, nr. 53886/00, 24 Nëntor 2005

dhe se gazetaria e përfundonte artikullin e saj duke deklaruar se një nga të akuzuarit ishte fajtor, cenonin të gjitha të drejtën për prezumimin e pafajësisë dhe për një gjykim të drejtë. GJEDNJ vlerësoi se gjykatat franceze kishin të drejtë në arsyetimin e tyre dhe se e drejta për lirinë e shprehjes së gazetarit duhej të ishte e balancuar me të drejtën për një gjykim të drejtë.

PINTO COELHO kundër PORTUGALISË⁵⁵

Në rastin në vijim, gazetari nuk u gjet fajtor nga GJEDNJ për shkeljen e prezumimit të pafajësisë së të akuzuarit. Gjykata kishte vendosur që me shfaqjen e kopjeve të dokumenteve që ishin të rëndësishme gjatë gjyimit për disa sekonda gjatë reportazheve, pas kryerjes së hetimit, nuk u cenua e drejta e të akuzuarit. Ndryshe nga rastet e tjera, ku gazetaret publikuan artikuj vetëm për të kënaqur kuriozitetin e lexuesve, Gjykata gjeti se reportazhi i gazetarit nuk ishte i njëanshëm, hetimi kishte përfunduar në momentin e publikimit dhe gazetari nuk po i publikonte dokumentet si mjetet senzacionalizmi, por vetëm për të informuar publikun. Për më tepër, GJEDNJ theksoi se dokumentet u përdorën, me të drejtë, nga gazetari për të vërtetuar informacionin dhe për të provuar kredibilitetin dhe besueshmërinë e tij.

VON HANNOVER kundër GJERMANISË

Aplikimi në rastin *Van Hanover kundër Gjermanisë⁵⁶* është paraqitur kundër një vendimi të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, i cili kishte rrëzuar kërkesën për të ndaluar publikimin e fotografive të Princeshës Carolina të Monakos me fëmijët e saj. Gjykatat më të ulëta gjermane vendosën ndalimin e botimit të fotografive në fjalë, duke theksuar se nevoja për të mbrojtur jetën private të fëmijëve ishte më e madhe se nevoja e një të rrituri. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë, arriti në përfundimin se në këtë rast nuk ka pasur shkelje të së drejtës së jetës private dhe se princesha si figurë publike, duhet të tolerojë publikimin e fotografive të saj në vende publike, edhe nëse ajo shfaqet në rutinën e përditshme të jetës së saj private dhe jo gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.

Duke vendosur në këtë rast, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbajti një qëndrim të ndryshëm dhe arriti në përfundimin se fotografitë e paparacëve regjistruhen në një klimë shqetësuese të vazhdueshme që shkakton një ndjenjë të fortë të ndërhyrjes në jetën private dhe madje edhe ndjesinë e persekutimit. GJEDNJ gjeti një shkelje të nenit 8 dhe arriti në përfundimin se publiku nuk kishte interes të ligjshëm për të parë se ku ishte kërkuësja ose si sillej ajo zakonisht në jetën e saj private edhe nëse ajo shfaqet në vende publike. Gjithkush, duke përfshirë personat e famshëm, duhet të kenë "pritshmërinë e ligjshme" se jeta e tyre private do të mbrohet.

55 *Pinto Coelho kundër Portugalisë, nr. 28439/08, 28 Qershor 2011*

56 See: Von Hannover kundër Gjermanisë, kërkesa nr.59320/00, 24 Qershor 2004;

VON HANNOVER kundër GJERMANISË NR. 2

Kërkesa në rastin Van Hannover kundër Gjermanisë nr. 2⁵⁷ u paraqit kundër vendimit të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, e cila kishte rrëzuar kërkesën për ndalimin e botimit të një fotografie të Princeshës Carolina të Monakos, e shoqëruar me një artikull mbi shëndetin e keq të babait të saj Princit Reiner III. Në vendimin e saj, në të cilën konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së, Gjykata u shpreh se personat publikë nuk mund të gëzonin të njëjtën mbrojtje si qytetarët e zakonshëm, se sjellja e mëparshme e një personi nuk mund të ishte bazë për mohimin e çdo mbrojtjeje nga publikimi i fotografive, se konteksti në të cilin njerëzit shfaqen në fotot që publikohen mund të jetë një faktor vendimtar dhe se mënyra e marrjes së fotografive (me leje ose njohuri paraprake ose të fshehura) mund të jetë gjithashtu e rëndësishme për marrjen e vendimit.

AXEL SPRINGER AG kundër GJERMANISË

Kërkesa në rastin **Axel Springer AG kundër Gjermanisë**⁵⁸ është paraqitur kundër vendimit të një gjykate gjermane që ndalon publikimin e një artikulli mbi arrestimin e një aktori të mirënjohur gjerman për posedim kokaine, duke mbajtur qëndrimin që për shkak të rëndësisë së vogël të veprës penale nuk ka interes publik për marrjen e informacionit lidhur me atë ngjarje. Në vendimin e saj duke konstatuar se kishte pasur shkelje të nenit 10 të KEDNJ-së, gjykata theksoi rolin e medias si kujdestar i interesit publik në një shoqëri demokratike dhe se mediat kanë për detyrë të botojnë informacione dhe ide për çështje me rëndësi për publikun dhe se publiku ka të drejtë t'i marrë ato. Gjithashtu, Gjykata deklaroi se për mbrojtjen e garantuar në nenin 8, sulmi mbi reputacionin e dikujt duhet të arrijë një shkallë serioze, në mënyrë që gëzimi i kësaj të konsiderohet i kërcënuar.

DELFI AS kundër ESTONISË

Vendimi me të cilin GJEDNJ në rastin e **Delfi AS kundër Estonisë**⁵⁹ konstatoi se ekzistenca e përgjegjësisë së portaleve të mediave për komentet e lexuesve nuk përbën shkelje të lirisë së shprehjes sipas nenit 10 të KEDNJ-së, ka hasur shumë kritika. Në vendimin e GJEDNJ-së në rastin e **MTE kundër Hungarisë**, vëmendje e veçantë iu kushtua faktit se ngarkimi me përgjegjësi i portaleve të internetit mund të ketë pasoja negative dhe çonte në mbylljen e seksionit të komenteve, të cilat mund të kishin pasoja negative për lirinë e shprehjes së vetë lexuesve. Megjithatë ky vendim nuk mund të përfaqësojë një shmangie thelbësore nga

57 Shih: Von Hannover kundër Gjermanisë nr. 2, kërkesa nr.40660/08, 7 Shkurt 2012;

58 Shih: Axel Springer kundër Gjermanisë, kërkesa nr.48311/10, 7 Shkurt 2012;

59 Shih: Delfi AS kundër Estonisë, kërkesa nr. 64569/09, 16 Qershor 2015;

rasti Delphi, rasti i MTE kundër Hungarisë tregon se GJEDNJ ende nuk e ka zgjidhur këtë çështje në mënyrë koherente për të gjetur ekuilibrin e duhur midis lirisë së shprehjes dhe kufizimeve të saj. Gjatë marrjes së vendimit në këtë rast, Gjykata mori parasysh natyrën ekstreme të komenteve në fjalë, fakti që komentet janë botuar në përgjigje të një artikulli të publikuar nga kërkuesi në portalin e tij të informacionit, fakti se komentet kanë baza komerciale, mungesa e masave të marra nga kërkuesit për të fshirë komentet fyese pa vonesë pas publikimit dhe sanksionet e moderuara të vendosura ndaj aplikantëve (320 euro).

MTE kundër HUNGARISË

Rasti i **MTE kundër Hungarisë**⁶⁰ ishte një mundësi që GJEDNJ të mbante qëndrim për të vendosur një baraspeshë më të mirë midis lirisë së shprehjes dhe kufizimeve të saj. Ky vendim, i cili konstatoi shkelje të nenit 10 të GJEDNJ-së, bazohej në një situatë faktike, në thelb e ndryshme, nga rasti i Delphi. GJEDNJ, duke gjetur se kërkuesit duhej të trajtoheshin si media, vlerësoi dallime të rëndësishme në lidhje me rastin Delphi dhe përmendi mungesën e fitimit si një motiv, si dhe mungesën e gjuhës së urrejtjes. Konkluzioni i Gjykatës ishte se komentet u botuan në portalin e internetit të kërkuesit, dhe ato kishin të bënin me abuzimin e agjencive shtetërore të pasurive të paluajtshme, e për rrjedhojë ato ishin të justifikuar dhe se publikimi i tyre ishte në interesin publik.

BORDI EDITORIAL PRAVOJE DELO AND ŠTEKEL kundër UKRAINËS

Në rastin e **Bordit Editorial Pravo Delo dhe Štekel kundër Ukrainës**⁶¹, gjykata pranoi për herë të parë se Neni 10 i Konventës duhet interpretuar si detyrim ndaj Shteteve Palë për të krijuar një kuadër rregullator të përshtatshëm për të garantuar mbrojtjen efektive të lirisë së shprehjes së gazetarëve në internet. Në këtë rast, kërkuesit u urdhëruan të paguajnë një tarifë për ri-publikimin e një teksti anonim, i cili, objektivisht, përmbante shpifje, dhe i shkarkuar nga interneti (me një hyrje që tregonte burimin dhe distancimin e tyre nga teksti). Ata gjithashtu u urdhëruan të publikonin përgënjeshttrimet dhe faljet – megjithëse kjo është përcaktuar me ligj.

Në legjisllacionin e Ukrainës, nuk parashikohet mbrojtje ligjore për gazetarët të cilët ri-publikojnë materiale nga interneti. Çdo masë që kufizon aksesin në informim, për të cilin publiku ka të drejtë ta marrë, duhet të justifikohet specifikisht me arsye bindëse.

60 Ibid.

61 Shih: Bordi Editorial i Pravoye Delo dhe Shtekel kundër Ukrainës, kërkesa nr.33014/05, 5 Maj 2011

STOL kundër ZVICRËS

Rasti i *Stol kundër Zvicrës*⁶² trajton rastin e një gazetari, i cili u gjobit për botimin e një raporti konfidencial të ambasadorit zviceran në Shtetet e Bashkuara mbi strategjinë që duhet të ndiqte Qeveria Zvicerane gjatë negociatave, me Kongresin Botëror Hebraik dhe bankat zvicerane, në lidhje me kompensimin e viktimave të holokaustit nga fondet e depozituara në bankat zvicerane. Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka argumentuar se, në parim, e drejta për lirinë e shprehjes mbrohet publikimin e materialit konfidencial në rastet kur ai i shërben interesit publik. Megjithatë, Gjykata vlerësoi se botimi i pjesëve të raportit të ambasadorit kishte pasoja negative në negociata, veçanërisht për shkak të artikujve të shkruar në mënyrë jashtëzakonisht të bujshme, të cilat pasuan publikimin e raportit. Gjykata vuri në dukje se gazetari, kërkuesi, duhej të dinte se botimi i raportit ishte një vepër penale. Kështu, duke marrë parasysh gjobën relativisht të ulët të vendosur ndaj gazetarit, Gjykata nuk gjeti se ishte shkelur e drejta e tij për lirinë e shprehjes. Duhet theksuar se pesë gjyqtarë (nga 17) nuk ishin dakord me vendimin, duke u shprehur se shumica e gjyqtarëve, në mendimet e tyre, u përqendruan në mënyrë të panevojshme në natyrën sensacionale të artikujve në vend të rëndësisë së një çështjeje me interes publik.

*TIMES 1 DHE 2 kundër MBRETERISË SË BASHKUAR*⁶³

Në këtë rast, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbajti qëndrimin se detyrimi i shtypit për t'iu përmbajtur parimeve të gazetarisë së përgjegjshme, do të thotë duke konfirmuar saktësinë e informacionit të publikuar (mirëbesimi, etika, informacioni i besueshëm), është edhe më i rreptë kur bëhet fjalë për informacionet që kanë të bëjnë me ngjarjet e kaluara në lidhje me të cilat nuk ka problematika urgjente. Ky detyrim është më i rreptë për arkivat e internetit që përfaqësojnë burimin kryesor të arsimit dhe kërkimit historik sesa me lajmet në lidhje me çështjet aktuale, të cilat janë përkufizuar si “mallrat që prishen” (Times 1 dhe 2 kundër Mbretërisë së Bashkuar)

62 Shih: Stoll kundër Zvicrës, kërkesa nr. 69698/01, 10 Dhjetor 2007;

63 Shih: Times 1 dhe 2 v. Mbretëria e Bashkuar, aplikacioni nr. 3002/03 dhe 23676/03, 10 maj 2009.



